



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS
NR. 1161 PROT.
DATA 15.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE

Nr. 16 Prot.

Vlorë më, 15/05/2024

VENDIM

Nr. 4, datë 15.05.2024

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSIVE BAZË
TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE**

Në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 22 dhe pikës 4 nenit 25 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë", Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Humane verifikoi dokumentacionin e kandidatëve për Drejtues të Njësive Bazë në Fakultetin e Shkencave Humane.

Me shkresën nr. 1140/1 prot., datë 15.05.2024 të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore vihemi në dijeni për dokumentacionin e kandidatëve për Drejtues të Njësive Bazë në Fakultetin e Shkencave Humane. Në përputhje me aktet ligjore më sipër rezultojnë se:

- znj. Kozeta Dashmir Hyso, kandidate për Drejtuese të Departamentit të Gjuhëve të Huaja zotëron titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite;
- znj. Veneranda Mitro Hajrulla, kandidate për Drejtuese të Departamentit të Gjuhëve të Huaja zotëron titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite;
- z. Aleks Godo Trushaj, kandidat për Drejtues të Departamentit të Edukimit zotëron titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite;
- znj. Esmeralda Sabri Laçi, kandidate për Drejtuese e Departamentit të Edukimit zotëron titullin akademik "Doktor" (PHD) dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite;
- znj. Jonida Ylqezar Mehmetaj, kandidate për Drejtuese e Departamentit Drejtësi zotëron titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite;
- znj. Monika Osman Hasani (Hoshafi), kandidate për Drejtuese të Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë zotëron titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite;

- z. Artan Niazi Xhaferaj, kandidat për Drejtues të Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë zotëron titullin akademik “Profesor i Asociuar” dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 5 vite.

Me shkresën nr. 1139/1 prot., datë 15.05.2024 të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore vihemi në dijeni se kandidatët më sipër për Drejtues të Njësive Bazë të Fakultetit të Shkencave Humane nuk kanë masë disiplinore në dosje.

Pas verifikimit të dokumentacionit dhe referuar shkresave Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Humane,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e kandidatëve për Drejtues të Njësive Bazë të Fakultetit të Shkencave Humane:
 - për Departamentin e Gjuhëve të Huaja, Znj. Kozeta Dashamir Hyso;
 - për Departamentin e Gjuhësve të Huaja. Znj. Veneranda Mitro Hajrulla;
 - për Departamentin e Edukimit, Z. Alekso Godo Trushaj;
 - për Departamentin e Edukimit, Znj. Esmeralda Sabri Laçi;
 - për Departamentin e Drejtësisë, Znj. Jonida Ylqezar Mehmetaj;
 - për Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Znj. Monika Osman Hasani (Hoshafi);
 - për Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Z. Artan Niazi Xhaferaj.
2. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane dhe në faqen zyrtare elektronike të universitetit: www.univlora.edu.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE

Deniz ÇUPI (Anëtare)

Migena MEMAJ (Anëtare)

KRYETAR

Klajdi MONE